



Datë: 11.12.2025
Numër Protokolli: 7851/2025

A.nr.1298/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1298/2025, të datës 07.07.2025, të parashtruar nga ankuesja S.G, kundër organit të punësimit/Ministra e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1298/2025, e datës 07.07.2025, e parashtruar nga ankuesja S.G.
- II. Pala ankuese udhëzohet mbi të drejtën e inicimit të kontestit juridik-civil pranë gjykatës kompetente.

A r s y e t i m

Ankuesja S.G (tutje referuar vetëm ankuesja), më datë 07.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për mos kompensim të mjeteve materiale nga Ministria e Mjedisit, Planifikimi, Hapësinor dhe Infrastrukturës, lidhur me funksionin shtesë sipas Vendimit Nr.13/2025 të datës 06.01.2025, të u.d Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimi, Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje referuar MMPHI), ndërsa, kjo e fundit ka përcjell vetëm provat ndërlidhur më çështjen duke mos dhënë përgjigje në pretendimet ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se:

- ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 18.07.2014, ka qenë e punësuar në pozitën Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor/Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit në MMPHI.

- Sipas Vendimit me numër protokolli 3797/24 të datës 10.06.2024, të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, është formuar Komisioni për Palët e Interesit për Projektet e Energjisë së Ripërtritshme, ku si përfaqësuese nga Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit është caktuar ankuesja, e cila njëkohësisht ka qenë në cilësi të kryesues së komisionit përkatës.

- Ankuesja më datë 18.11.2024, ka parashtruar kërkesë për kompensim për funksionin shtesë tek u.d Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI-së, mbi bazën e angazhimit sipas Vendimit me numër protokolli 3797/24 të datës 10.06.2024, ndërsa, ky i fundit më Vendimin me numër protokolli 13/25 të datës 06.01.2025, ka aprovuar kërkesën e ankueses për kompensim të funksionit shtesë në vlerën 30% të pagës bazë.

- MMPHI ka përgatitur formularin për pagesë retroaktive për ankuesen për kompensim për funksion shtesë në vlerën 2,428.80 Euro, mirëpo sipas shpjegimeve të dhëna në emalin e datës 11.03.2025, ky formular nuk është nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Financiar me arsyetimin se duhet pritur si po vendosen ankesa që i kanë bërë anëtarët e këtij komisioni në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

- Më datë 03.02.2025, Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore të MMPHI-së ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 568/25, për përfundimin e marrëdhënia së punës së ankueses për arsye të arritjes së moshës së pensionimit, me efekt nga data 05.03.2025.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk i është bërë kompensimi për funksion sipas Vendimit me numër protokolli 13/25 të datës 06.01.2025, duke shtuar se mos kompensimi është në kundërshtim me rregullativen ligjore ngase kjo është një e drejtë që del nga dispozitat ligjore në fuqi dhe vet vendimi i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së. Kërkon që të aprovohet ankesa dhe të bëhet kompensimi i mjeteve monetare për funksion shtesë.

Rrjedhimisht, në kuptim të kompetencës materiale të Këshillit për vendosje lidhur me këtë çështje juridike-administrative, Kolegji fillimisht thekson faktin se ankuesja deri me datë 04.03.2025, kishte statusin e nëpunësit civil, gjegjësisht, nga data 05.03.2025, ankuesja ka humbur statusin e nëpunësit civil për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Andaj, duke u bazuar në nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më të cilin përcaktohet së Këshilli ka juridiksion që të shqyrtoj vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, atëherë, duke qenë së ankuesja më rastin e parashtrimt të ankesës në Këshill nuk ka statusin e nëpunësit aktiv civil, kolegji konstaton se Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses A.nr.1298/2025.

Kolegji po ashtu mori parasysh faktin së ankuesja paraprakisht ka qenë e njoftuar për përfundimin e marrëdhënies së punës si rezultat i arritjes së moshës së pensionimit, atëherë, duke qenë së e njëjta nuk ka parashtruar ankesë në Këshill deri në ditën e pensionimit ku e njëjta mbante statusin e nëpunësit civil, Kolegji erdhi në përfundimin se Këshill nuk posedon tager ligjor që të vendos lidhur me ankesën, sepse, siç u tha me sipër ankuesja ka humbur statusin e nëpunësit civil, rrjedhimisht, ankesa është parashtruar pesë (5) muaj pas humbjes së këtij statusi ligjor.

Si rrjedhojë, referuar pretendimeve ankimore të parashtruara si në ankesë, rezulton se në rastin konkret kemi të bëjmë me raport juridiko-civil, pasi që kemi të bëjmë me kompensim material, kështu që, Kolegji lidhur me të drejtën e ankuesit në mjete juridike si e drejtë kushtetuese garantuar me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejta e Njeriut (neni 13), udhëzon palën ankuese që drejtën e tij materiale të pretenduar si në ankesë ta realizoj në kontest civil në pajtim me dispozitat e Ligjit përkatës për Procedurën Kontestimore. Gjegjësisht, lënda nuk mund të bartet tek gjykata kompetente ngase në këtë fazë mungon padia si kusht kryesor për fillimin e një procesi gjyqësor.

Thënë si me sipër e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda:A.nr.1298/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses S.G;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MMPHI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.